

AMF ofron disa shërbime *online* përmes e-Albania

Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar–nëntor 2021

Zhvillime të tjera

- AMF organizon takimin e fundvitit me tregjet nën mbikëqyrje
- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF, takim me Shoqatën Shqiptare të Bankave
- AMF zhvillon aplikacionin për përlogaritjen e dëmeve ndaj personit në aksidentet rrugore
- Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar

Publikime Profesionale

- “Global Risk Regulator”
 - FINMA inkurajon bumën zviceran të krypto-monedhave
 - Këndi i debatit të hapur: Arsyeja për një pasaportë të depozitarëve të fondeve të BE-së
- IOPS
Publikohet “Materiali Diskutimi” Nr. 37, tetor 2021, i IOPS-it rreth mbikëqyrjes efektive të pensioneve - “Qasjet mbikëqyrëse për të rritur elasticitetin kibernetik në sektorin e pensioneve private”

Edukimi Financiar


- BIS
“Politika makroprudenciale për ndërmjetësimin financiar jobankar” - Fjala e Z. Luis de Guindos, Zëvendës President i Bankës Qendrore Evropiane, në Konferencën e 5-të vjetore të ESRB-së

Informacione Ndërkombëtare

- Bullgari
- Greqi
- Hungari
- Qipro
- Rumani
- Serbi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF ofron disa shërbime *online* përmes e-Albania



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim lehtësimin e procedurave të qytetarëve, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për t'u pajisur me informacionet apo vërtetimet e nevojshme në lidhje me sigurimin e detyrueshëm të automjeteve, ka mundur ofrimin e disa shërbimeve elektronike në kohë reale nëpërmjet portalit e-Albania.

Çdo policë e sigurimit të detyrueshëm motorik e lëshuar nga shoqëritë e sigurimit do të raportohet në kohë reale në Regjistrin Online të AMF-së, i cili në ndërveprim me e-Albania do t'u mundësojë qytetarëve të verifikojnë po në kohë reale policën e tyre të sigurimit të detyrueshëm.

Qytetarët do të marrin në kohë reale në portalin e-Albania, informacionin e nevojshëm që lidhet me:

- Vlefshmërinë e policës së sigurimit;
- Historikun e sigurimit të mjeteve në pronësi të qytetarit;
- Historikun e dëmeve të mjeteve motorike;
- Njoftimin për përfundimin e afatit të policës së sigurimit.

Verifikimi i policës së sigurimit motorik

Nëpërmjet shërbimit elektronik "Verifikimi i policës së sigurimit motorik", çdo person i cili ka në pronësi një mjet motorik mund të kërkojë nëpërmjet kësaj platforme dokumentin me vulë elektronike, që vërteton se pronari i këtij mjeti ka lidhur kontratën e sigurimit të detyrueshëm motorik. Dokumenti i gjeneruar nga e-Albania përmban:

- Të dhëna për mjetin motorik, si nr. shasie, targë, lloji i mjetit, modeli, viti i prodhimit;
- Të dhëna për pronarin e mjetit dhe përdoruesin e tij;

Të dhëna për policën aktive të sigurimit, si kodi i raportimit, numër serie, vlefshmëria dhe lloji i policës së sigurimit.

Nëpërmjet këtij shërbimi qytetarët sigurohen në kohë reale se janë të pajisur me një policë të vlefshme për sigurimin e detyrueshëm motorik, duke shmangur rastet e keqinterpretimeve apo abuzimeve.

Linku për t'u lidhur me portalin e-Albania:

<https://e-albania.al/eAlbaniaServices/Ins titutionDetails.aspx?id=134>

AMF ofron mundësinë e marrjes së disa shërbimeve online përmes e-Albania



... vijon

Historiku i policave MTPL të mjeteve motorike

Nëpërmjet shërbimit elektronik "Historiku i policave MTPL të mjeteve motorike", qytetarit i shfaqen mjetet që ka aktualisht në pronësi ose ka patur në pronësi. Për çdo mjet të zgjedhur për një periudhë kohore 7-vjeçare, me kërkesë të qytetarit shfaqen të dhënat historike të policave motorike për mjetin. Dokumenti me vulë elektronike përmban të dhëna për çdo policë sigurimi që lidhet me këtë mjet motorik, si kodet e raportimit, shoqëria e sigurimit që ka lëshuar policën e sigurimit, vlefshmërinë e policës së sigurimit, primin e paguar për policën e sigurimit, targën, specifikat e mjetit, etj. Ky dokument zyrtar u shërben qytetarëve, si atyre rezidentë jashtë vendit, ashtu edhe atyre brenda vendit për të vërtetuar mbulimin me sigurim të detyrueshëm motorik për një periudhë të caktuar përgjatë 7-vjeçarit të fundit.

Historiku i dëmeve të mjeteve motorike

Nëpërmjet shërbimit elektronik "Historiku i dëmeve të mjeteve motorike", çdo person i cili ka në pronësi një mjet motorik dhe është bërë shkaktar i një aksidenti rrugor, mund të kërkojë nga kjo platformë për një periudhë 7-vjeçare pas datës së aksidentit, të dhënat që lidhen me aksidentin ku është përfshirë mjeti i tij. Kjo vlen për të gjitha mjetet në pronësi të tij brenda kësaj periudhe kohore. Dokumenti me vulë elektronike, që gjenerohet nga e-Albania përmban disa të dhëna, si datën e aksidentit, të dhënat e mjetit, llojin e dëmit, vlerën dhe statusin aktual të dëmshpërblimit. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të pajisen me një dokument zyrtar, i cili mund të përdoret si për qytetarët rezidentë jashtë vendit, ashtu edhe për nevojat e qytetarëve brenda vendit.

Njoftimi për përfundimin e policës së sigurimit

Shërbimi elektronik "Njoftimi për përfundimin e policës së sigurimit" do të realizohet nëpërmjet dërgimit të mesazhit në seksionin "mesazhet e mia" në e-Albania. Në këtë mënyrë, çdo pronar i mjetit motorik njoftohet për përfundimin e policës së sigurimit, 15 ditë përpara afatit të përcaktuar si datë mbarimi. Kjo shërben për t'i ndërgjegjësuar qytetarët, duke i dhënë atyre kohën e nevojshme për të rinovuar brenda afatit policën e sigurimit të detyrueshëm motorik.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar–nëntor 2021


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar–nëntor 2021 kapën vlerën 17,370 milionë lekë, ose 17.59% më shumë se në janar–nëntor 2020. Gjatë periudhës janar–nëntor 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,055,799 me një rritje prej 23.12% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.69% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.16%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.51% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.49% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar–nëntor 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,001 milionë lekë, ose 11.88% më pak se në periudhën janar–nëntor 2020, ndikuar kryesisht nga pagesa e pjesës më të madhe të dëmshpërblimeve për tërmetet e fund vitit 2019 gjatë vitit të kaluar.

Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar–nëntor 2021 kapën vlerën 3,629 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 25.35% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar–nëntor 2021 (Në %)



Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar–nëntor 2021 kapën vlerën 3,629 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 25.35% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Zhvillohet mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar



Tiranë, 29 dhjetor 2021 – Takimi i Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar

Në datën 29 dhjetor 2021, u zhvillua mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje, e cila u drejtua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë (BSH), Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Drejtori i Përgjithshëm i AMF-së, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Programi i mbledhjes përfshinte vlerësimet më të fundit të autoriteteve të pranishme, mbi zhvillimet në institucionet dhe tregjet që mbikëqyrin.

Në prezantimin e BSH-së me fokus tek vlerësimi i gjendjes financiare të sektorit bankar, u theksua se gjatë 2021 zhvillimet ishin pozitive, duke reflektuar rezistencën e ekonomisë ndaj ndikimit të pandemisë. Tregjet financiare funksionuan normalisht, ku normat e interesit mbetën në nivele të ulëta dhe treguan luhatshmëri të ulët në lëvizje. Veprimtaria e sektorit bankar u zgjerua në mënyrë të ndjeshme, në kushtet e rritjes së fortë të depozitave të publikut dhe drejtimit të tyre në investime ndërbankare, tituj dhe kredi. Kreditë me probleme zbritën në rreth 41 miliardë lekë, duke bërë që raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredisë të bjerë në nivelin 6.2% në muajin nëntor. Në rënien e këtij treguesi ka ndikuar edhe rritja e mirë e nivelit të kreditimit. Treguesit e rreziqeve të tregut nuk shfaqën ndryshime të rëndësishme gjatë vitit. Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet vlerësohet e fortë në kushtet kur gjendja e likuiditetit është mjaft e mirë dhe kur veprimtaria bankare paraqitet fitimprurëse dhe e mirëkapitalizuar. Vijimi i përmirësimit të cilësisë së kredisë, edhe disa muaj pas ndërprerjes së masave rregullative mbështetëse të BSH-së, është inkurajues. Megjithatë, gjatë vitit 2022 BSH do t'i kushtojë vëmendje të posaçme analizës së kredive me probleme, nëpërmjet veprimeve të dedikuara mbikëqyrëse në sektorin bankar.

Në kuadër të analizës së rreziqeve sistemike që lidhen me strukturën e ekonomisë, të pranishmit u njohën me një analizë të ndërtuar nga BSH mbi llogaritë financiare kombëtare dhe ndërlidhjen mes sektorëve institucionalë. Ekonomia shqiptare ka një pozicion neto debitor ndaj pjesës tjetër të botës, në kushtet kur detyrimet janë më të mëdha se mjetet. Ky pozicion është ndikuar nga pozicionet neto negative të korporatave jofinanciare (bizneseve) dhe të Qeverisë së Përgjithshme, ndërsa pozicionet e ekonomive familjare dhe të korporatave financiare kontribuojnë pozitivisht. Nisur nga kjo strukturë dhe duke vlerësuar flukset e financimit midis sektorëve, mund të ndërtohen tregues të cilët evidentojnë rreziqet që rrjedhin nga pozicionet e sektorëve të caktuar. Më tej, për të kontrolluar këto rreziqe mund të merren masa në kuadër të politikave ekonomike dhe financiare, që synojnë zvogëlimin e pozicioneve neto negative. BSH është duke e zhvilluar këtë analizë jo vetëm për sektorët institucionalë të ekonomisë por edhe për segmentet kryesorë të sistemit financiar. Të pranishmit vlerësuan se bashkëpunimi ndërinstitucional për këtë qëllim do të ishte i dobishëm.

Përdorimi i tepërt i valutës në ekonomi, jo rrallë edhe si mjet pagese, mbetet një nga burimet e rëndësishme të rrezikut financiar dhe ndikon në uljen e efektivitetit të politikave ekonomike dhe financiare. Për këtë arsye, të pranishmit diskutuan rreth nevojës dhe mundësive që masat për uljen e përdorimit të valutave dhe fuqizimin e përdorimit të monedhës kombëtare, aktualisht të përqendruara në sektorin bankar, të shtrihen në mënyrë të kujdesshme edhe në sektorët realë të ekonomisë. Për këtë qëllim, të pranishmit u angazhuan për bashkëpunim ndërinstitucional, i cili mund të mbështetet edhe me ekspertizë nga institucionet financiare ndërkombëtare.

AMF i njohu të pranishmit me zhvillimet në kuadrin ligjor e rregullativ, si edhe me ecurinë e tregjeve financiare që mbikëqyr ky institucion. Me objektivin për të rritur përputhshmërinë me standardet më të mira të fushës, u evidentua miratimi i disa ligjeve të rëndësishme, ku përfshihen ato 'Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit', "Për tregjet e kapitalit", "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", "Për tregjet financiare të bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë" dhe përgatitja e projektligjit "Për fondet e pensionit privat". Ka avancuar gjithashtu puna për përgatitjen e bazës nënligjore për këto ligje. Në prezantim u evidentuan zhvillimet në fondet private vullnetare të pensionit, fondet e investimeve dhe tregun me pakicë të letrave me vlerë. Tek ky i fundit, mbizotërojnë transaksionet mes individëve dhe preferenca për titujt afatshkurtër të borxhit të qeverisë. Për tregun e sigurimeve, përfaqësuesit e AMF-së evidentuan rritjen e primeve të paguara bruto gjatë vitit, po edhe rritjen më të shpejtë të dëmeve të paguara. Struktura e tregut mbizotërohet nga sigurimi i detyrueshëm motorik, i cili gjeneron edhe pjesën më të madhe të primeve të shkruara bruto. Në tërësi, edhe këto tregje kanë treguar qëndrueshmëri dhe rritje të mirë të aktivitetit, pavarësisht ndikimit të pandemisë. Në vijim, u diskutua për disa çështje që lidhen me bashkëpunimin ndërinstitucional për përmirësimin e funksionimit të këtyre tregjeve.

AMF i njohu të pranishmit me zhvillimet në kuadrin ligjor e rregullativ, si edhe me ecurinë e tregjeve financiare që mbikëqyr ky institucion.

Drejtuesit e institucioneve pjesëmarrëse në takim vlerësuan pozitivisht zhvillimet në sistemin financiar, në tregjet financiare dhe në kuadrin rregullativ përkatës, duke konfirmuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar.

Në mbledhjet e GKSF-së marrin pjesë rregullisht edhe përfaqësues të ASD-së. Në këtë mbledhje përfaqësuesit e ASD-së bënë një prezantim të ecurisë së depozitave pranë bankave dhe pranë shoqërive të kursim-kreditit (shkk). Gjatë vitit të kaluar, depozitat e sigurueshme kanë njohur rritje si tek bankat ashtu edhe tek shkk-të. Në total, depozitat e sigurueshme vijojnë të mbizotërohen nga kursimet e individëve dhe shfaqin një epërsi të lehtë të depozitave në valutë. Numri i depozituesve me llogari në lek, mbizotëron në numrin total të depozituesve. Sipas afatit të maturimit, depozitat e sigurueshme të individëve mbizotërohen nga depozitat me afat, ndërsa depozitat e tregtarëve dhe shoqërive tregtare janë të përqendruara tek llogaritë rrjedhëse. Në përputhje me ecurinë e depozitave të sigurueshme, edhe fondi i sigurimit të depozitave ka shënuar rritje gjatë vitit të kaluar. Burimi i financimit të fondit të sigurimit gjatë vitit të kaluar, siç parashikon ligji në situata normale, ishin pagesat e primit të sigurimit nga bankat dhe shkk-të, dhe administrimi i mjeteve financiare nga ASD-ja. Në kushtet e pandemisë dhe nga këndvështrimi i kujdesit, ASD i fuqizoi këto burime me linjën e kredisë të vënë në dispozicion nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Pas diskutimit të çështjeve të mësipërme, drejtuesit e institucioneve vlerësuan pozitivisht zhvillimet në sistemin financiar, në tregjet financiare dhe në kuadrin rregullativ përkatës, duke konfirmuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Kjo qëndrueshmëri nuk u cënua nga ndikimi i pandemisë. Drejtuesit e institucioneve theksuan rëndësinë e monitorimit të zhvillimeve financiare, pasi situata ekonomike dhe ajo e shëndetit publik ndeshen me sfida të vazhdueshme.

Me mbylljen e diskutimeve në mbledhje sipas programit, drejtuesit e institucioneve pjesëmarrëse miratuan këtë njoftim për shtyp dhe autorizuan publikimin e tij.

AMF organizon takimin e fundvitit me tregjet nën mbikëqyrje



Tiranë, 22 dhjetor 2021 - Z. Ervin Mete në takimin e fundvitit me tregjet nën mbikëqyrje

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi më 22 dhjetor 2021 takimin e fundvitit me drejtuesit e shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje. Në fjalën e mbajtur, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete, bëri një pasqyrim të ecurisë dhe zhvillimeve përgjatë vitit 2021, si edhe parashitroi disa nga objektivat e Autoritetit për vitin në vazhdim.

Z. Mete u shpreh se tregjet nën mbikëqyrje kanë shënuar rritje dyshifrore, jo vetëm krahasuar me vitin 2020, por edhe me vitin 2019. Rritja ka qenë si në nivel të ardhurash, nga primet në tregun e sigurimeve, ashtu edhe në nivel asetesh sa i përket fondeve të investimeve dhe atyre të pensioneve private, por edhe në nivel anëtarësh. Gjithashtu ka një përmirësim të treguesve të likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit dhe mbulimit me provigjone.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vlerësoi rolin e drejtuesve të shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje sa i përket masave të marra për të përballuar efektet e pandemisë COVID-19, përmes miratimit të planeve të vijmësisë së biznesit dhe ruajtjes së niveleve të përshtatshme të likuiditetit. Gjithashtu, ai vlerësoi shoqëritë e sigurimit në trajtimin e dëmeve të tërmeteve të vitit 2019.

Z. Mete theksoi se përgjatë muajve të fundit është realizuar një riformatim ligjor e rregullator domethënës, duke u ndryshuar pjesa më e madhe e ligjeve të tregjeve nën mbikëqyrje. Në zbatim të ligjeve të reja, Autoriteti është në fazën finale të miratimit të bazës rregulatore. Gjithashtu, është në proces të konsultimit publik projektligji “Për fondet private të pensioneve”.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nënvizoi se harmonizimi i legjislationit me atë të Bashkimit Evropian ka shtuar mundësitë e ndërlikohjes dhe ka diversifikuar hapësirat, duke sjellë një vëmendje të shtuar të emrave të rëndësishëm evropianë për të qenë të pranishëm në vendin tonë, përmes platformave të ndërlikohjes me tregjet ndërkombëtare, ose fondeve të investimit.

I pranishëm në takimin e organizuar nga AMF, ishte Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, z. Eduard Shalsi I cili vlerësoi rolin e AMF-së në garantimin e stabilitetit të tregjeve financiare jobankare. Ai shprehu gjithashtu mbështetjen për çdo nismë legjislative në funksion të thellimit të pavarësisë institucionale dhe mirërregullimit e zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve nën mbikëqyrje.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF, takim me Shoqatën Shqiptare të Bankave



Tiranë, 16 dhjetor 2021 - Z. Ervin Mete në pritjen e fundvitit të Shoqatës Shqiptare të Bankave

Gjatë vitit 2021 u konsolidua më tej bashkëpunimin mes AMF-së dhe bankave tregtare si aktorë të rëndësishëm në tregjet e kapitalit dhe fondet e investimit e pensionet private, si edhe në sektorin e sigurimeve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete ishte i pranishëm në pritjen e fundvitit të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB). Në fjalën e mbajtur, z. Mete theksoi se viti 2021 konsolidoi më tej bashkëpunimin mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe bankave tregtare si aktorë të rëndësishëm në tregjet e kapitalit dhe fondet e investimit e pensionet private, por edhe në sektorin e sigurimeve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se ligjet e reja në tregjet e kapitalit dhe fondet e investimit kanë diversifikuar hapësirat e investimit dhe ndërlidhjes në tregjet financiare. Gjithashtu, përgjatë këtij viti bankat i janë nënshtruar ndryshimeve ligjore e rregullatore në lidhje me përshtatshmërinë, si edhe zgjerimin e aktivitetit të tyre, përmes ofrimit të shërbimeve të reja të investimit.

Përmirësimi i kuadrit ligjor përmes rritjes së kërkesave për transparencë dhe forcimit të rolit mbikëqyrës e rregullator, ka qenë ndër objektivat e Autoritetit. Nëpërmjet kësaj synohet rritja e besimit në mekanizmat e tregut, si element thelbësor që nxit pjesëmarrjen e investitorëve, duke shfrytëzuar dimensionet e reja të ofruara nga ligji, theksoi z. Mete.

Bankat tregtare luajnë një rol të rëndësishëm në tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF, duke qenë se zotërojnë pjesën më të madhe të shoqërive administruese të fondeve të investimeve dhe pensioneve private, si edhe shërbejnë si Depozitarë të tyre. Gjithashtu, bankat ofrojnë shërbime në fushën e sigurimeve, kryesisht në rolin e brokerit.

AMF zhvillon aplikacionin për përlllogaritjen e dëmeve ndaj personit në aksidentet rrugore



amf@amf.gov.al +355-(0)-4-2257560 Kontrolllo

KREU AMF MBROJTJA E KONSUMATORIT CONTACT US DEPOZITO ANKESË

Kreu / Mbrojtja e Konsumatorit / Përlllogaritësi i Dëmit Përlllogaritësi i dëmit ndaj personit

Kujdes! Plotësoni fushat e detyruara të shënuara me *.

Të dhënat tuaja	
Data e aksidentit*	Datëlindja*
<input type="text" value="dd/mm/yyyy"/>	<input type="text" value="dd/mm/yyyy"/>
Gjinia*	Të ardhurat Personale Vjetore në kohën e ngjarjes*
<input type="text" value="Zgjidhni gjininë"/>	<input type="text"/>
Koeficienti i Humbjes së Aftësisë për Punë*	Numri i Personave në ngarkim*
<input type="text" value="Zgjidhni një opsion"/>	<input type="text"/>
Punësimi*	Motra / Vëllezer*
<input type="text" value="Zgjidhni një opsion"/>	<input type="text"/>
Shpenzimet Farmaceutike & Spitalore*	
<input type="text"/>	

Llogarit

Aplikacioni gjendet në faqen
zyrtare të AMF:
<https://crm.amf.gov.al/deme>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka zhvilluar aplikacionin e llogaritësit të dëmeve ndaj personit, në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në sektorin e transportit. Aplikacioni bazohet në Rregulloren nr. 125, datë 28.07.2021 "Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", miratuar nga Autoriteti në zbatim të Ligjit për "Sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2021.

Ky aplikacion u vjen në ndihmë palëve përfituese, si edhe vetë profesionistëve/ekspertëve të fushës në vlerësimin e dëmit dhe trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim. Përlllogaritësi bazohet në disa supozime, vlerat e përlllogaritura janë orientuese dhe synojnë të informojnë përdoruesit mbi masën e dëmshpërblimit.

Aplikacioni është ndërtuar për përlllogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit në rastet e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë ose me pasojë vdekjen.

Risitë që sjell zhvillimi i këtij aplikacioni për të siguruarit dhe profesionistët e fushës janë:

- Përlllogaritja automatike e vlerës së dëmit;
- Transparencë mbi vlerën e dëmit pasuror dhe dëmit jopasuror. Pasqyrimi i vlerës për çdo figurë dëmi;
- Mundësi përdorimi të aplikacionit nga ana e të dëmtuarve, si edhe profesionistëve/ekspertëve të fushës së sigurimeve, mbi bazën e disa supozimeve;
- Edukim të konsumatorëve në fushën e sigurimeve.



FINMA encourages Swiss crypto boom

Justin Pugsley | December 16, 2021



Switzerland has emerged as a hotbed of blockchain innovation and is pioneering capital market technologies thanks to the benign regulatory regime established under the Swiss Financial Market Supervisory Authority.

1. FINMA inkurajon bumin zviceran të krypto-monedhave

(FINMA encourages Swiss crypto boom)

Justin Pugsley

Zvicra është shfaqur si një vatër e inovacionit *blockchain* dhe është pioniere për teknologjitë e tregut të kapitalit, falë regjimit rregullator të mirë të vendosur nën Autoritetin Zviceran të Mbikëqyrjes së Tregut Financiar.

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/Finma-encourages-Swiss-crypto-boom?ct=true>

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Regulatory-Relations/The-rationale-for-an-EU-fund-depository-passport>

2. Këndi i debatit të hapur: Arsyeja për një pasaportë e depozitarëve të fondeve të BE-së

(The rationale for an EU fund depository passport)

Christopher P. Buttigieg, PhD,

Drejtues Mbikëqyrjes

Autoriteti i Shërbimeve Financiare të Maltës.

Ndërtimi i tregut të brendshëm, në fushën e shërbimeve financiare, u krijua kryesisht mbi parimin e njohjes reciproke ndërmjet shteteve anëtare, i cili është i lidhur dhe varet nga nivele të ndryshme të harmonizimit të legjislacionit dhe konvergencës mbikëqyrëse. Operatorëve të autorizuar të shërbimeve financiare u jepet një pasaportë për të ofruar produkte dhe shërbime në të gjithë BE-në bazuar në një njoftim tek rregullatori pritës, por pa kërkuar autorizime shtesë në shtetin anëtar pritës.

**Supervisory approaches
to enhancing cyber resilience in the private
pension sector:
High-level summary of Members responses
to the questionnaire**

Nina Paklina
October 2021



Publikohet “Materiali Diskutimi” Nr. 37, Tetor 2021, i IOPS-it rreth mbikëqyrjes efektive të pensioneve

“Qasjet mbikëqyrëse për të rritur elasticitetin kibernetik në sektorin e pensioneve private: Përmbledhje e përgjigjeve të anëtarëve në një pyetësor”

Nina Paklina

Tetor 2021

Materiali i Diskutimit dhe raportet e publikuara analizojnë kërcënimet dhe tendencat kryesore kibernetike të vërejtura në lidhje me incidentet kibernetike në sektorin privat të pensioneve në vitet e fundit dhe me specifikisht gjatë periudhës së Covid-19. Materiali nënvizon praktikatat mbikëqyrëse që kontribuojnë në mbikëqyrjen efektive të rrezikut të sigurisë kibernetike në sektorin privat të pensioneve. Anketimit i janë përgjigjur autoritetet rregullatore nga 36 juridiksione, anëtarë të IOPS.

Raporti shqyrton rregulloret e fundit mbi sigurinë kibernetike, veçanërisht ato që mbulojnë subjektet private të pensioneve. Raporti përfshin pikëpamjet mbikëqyrëse dhe vlerësimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut kibernetik dhe identifikon një sërë fushash që kërkojnë vëmendje më të madhe. Mbikëqyrësit në përgjithësi po miratojnë një qasje ndërsektorale ndaj kërcënimeve kibernetike. Raporti fokusohet në iniciativat mbikëqyrëse të vendosura për të monitoruar më mirë kërcënimet kibernetike në zhvillim dhe masat e drejtuara për të përmirësuar qëndrueshmërinë operacionale të njësive dhe menaxhimin e rrezikut kibernetik. Këto iniciativa mbikëqyrëse materializohen në udhëzimeve mbikëqyrëse, kornizat e vetëvlerësimit, ekzaminimet mbikëqyrëse, auditimet, raportimet dhe përdorimi i inteligjencës kibernetike ndaj kërcënimeve.

Së fundi, raporti ofron gjetje dhe përfundime kyçe për të forcuar sigurinë kibernetike nën këtë mjedis të ndikuar nga pandemia e koronavirusit.



<http://www.iopsweb.org/WP-37-IOPS-Supervisory-Approaches-Enhancing-Cyber-Resilience.pdf>

Central bank hub

Overview

Central bank and monetary authority websites

Central bankers' speeches

Research hub

Luis de Guindos: Macroprudential policy for non-bank financial intermediation

Speech by Mr [Luis de Guindos](#), Vice-President of the European Central Bank, at the Fifth ESRB (European Systemic Risk Board) annual conference, Frankfurt am Main, 8 December 2021.

Central bank speech | 10 December 2021
by [Luis de Guindos](#)
[PDF full text \(54kb\)](#) | 3 pages

Politika makroprudenciale për ndërmjetësimin financiar jobankar

Fjala e Z. Luis de Guindos, Zëvendës President i Bankës Qendrore Evropiane, në Konferencën e 5-të Vjetore të ESRB-së (Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik), Frankfurt am Main, 8 dhjetor 2021.

(Marrë me shkurtime dhe redaktime)

Do të filloj duke nënvizuar pse një qasje makroprudenciale ndaj institucioneve jobankare ka rëndësi nga këndvështrimi i bankës qendrore, duke prekur politikën monetare dhe konsideratat e stabilitetit financiar. Më pas do të nënvizoj disa shembuj të eksternaliteteve kryesore që u shfaqën në sektorin financiar jobankar në fillimin e pandemisë COVID-19. Së fundi, do të ndaj disa konsiderata mbi mundësitë e ecjes përpara, për një qasje makroprudenciale ndaj ndërmjetësimit financiar jobankar (NBF1).

Pse një qasje makroprudenciale ndaj NBF1-së ka rëndësi nga një perspektivë e bankës qendrore

Sektori financiar jobankar është rritur ndjeshëm në madhësi gjatë dekadës së fundit dhe është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm për financimin e ekonomisë reale. Në eurozonë, aktivet financiare të institucioneve financiare jobankare janë më shumë se dyfishuar që nga kriza financiare globale. Rrjedhimisht, ky sektor është bërë një burim i rëndësishëm financimi për ekonominë reale, ku pjesa e tij në kredinë e përgjithshme për korporatat jofinanciare është rritur nga rreth 15% në 30%. Kjo ka përfitime të qarta për korporatat jofinanciare që kërkojnë të diversifikojnë burimet e tyre të financimit përmes financave të bazuara në banka dhe në treg. Nga perspektiva e bankës qendrore, ajo ka gjithashtu implikime si për stabilitetin financiar ashtu edhe për politikën monetare.

Fjala e plotë e Luis de Guindos: “*Macroprudential policy for non-bank financial intermediation*” gjendet në linkun:

<https://www.bis.org/review/r211210a.htm>

Jo-bankat janë gjithashtu vendimtare për transmetimin e politikës monetare. Megjithatë, që politika monetare të transmetohet pa probleme, është e rëndësishme që institucionet jobankare të mund të ofrojnë një burim të qëndrueshëm financimi përgjatë ciklit financiar.² Më gjerësisht, në përputhje me konkluzionet e rishikimit të strategjisë sonë të fundit, stabiliteti financiar është një parakusht për stabiliteti i çmimeve dhe anasjelltas.³ Për këtë qëllim, nevojiten politika makroprudenciale efektive për të mbajtur larg rreziqet e stabilitetit financiar dhe për të plotësuar politikën monetare në ndjekjen e objektivit të saj të stabilitetit të çmimeve.

Dobësitë në financat jobankare dhe eksternalitetet e mundshme

Gjatë trazirave të tregut në mars 2020, u bë e qartë se pjesë të sektorit financiar jobankar nuk ishin mjaftueshëm elastike për të absorbuar goditjet me të cilat përballeshin. Këto goditje u përhapën më pas në sektorë të tjerë të sistemit financiar. Fondet e tregut të parasë dhe fondet më pak likuide të obligacioneve të korporatave u vunë nën stres, pasi u përballën me riblerje të mëdha në të njëjtën kohë me një rënie të likuiditetit bazë të tregut. Ndërsa investitorët hoqën disa nga aktivet e tyre dhe korporatat përpiqeshin për para, ekzistonte rreziku që presionet në rritje të likuiditetit do të forconin stresin e tregut dhe do të çonin në një humbje më të gjerë të besimit. Ndërhyrjet në kohë të bankave qendrore ndihmuan në frenimin e stresit dhe qetësimin e tregjeve financiare.

Megjithatë, kishte dobësi në financat jobankare që krijuan eksternalitete negative gjatë trazirave të tregut në fillimin e pandemisë në mars 2020.

Rruga përpara për forcimin e kuadrit rregullator të NBFi nga një këndvështrim makroprudencial

Deri më sot, kuadri i politikës makroprudenciale është fokusuar kryesisht në sektorin bankar. Ndërkaq, kuadrit për sektorin financiar jobankar i mungon në një masë të madhe një perspektivë makroprudenciale. Kjo do të thotë se ka më pak masa mbrojtëse në hapësirën jobankare dhe, gjatë periudhave të kushteve të mira të tregut, rreziqet mund të rriten kryesisht të pakontrolluara. Por ndërsa kushtet e tregut përkeqësohen, ekziston rreziku që jobankat të përforcojnë goditjet. Siç e kam shpjeguar, kjo është ajo që pamë në fazat e hershme të pandemisë, kur roli i MMF-ve (*Money Market Funds*) dhe fondeve të hapura ishte në kontrast me atë të sektorit bankar. Në vend që të përforconte goditjen, sektori bankar ndihmoi në përthithjen e tij.

Fjala e plotë e Luis de Guindos: “*Macroprudential policy for non-bank financial intermediation*” gjendet në linkun:

<https://www.bis.org/review/r211210a.htm>

gjithashtu nevojitet që autoritetet të ndjekin një qasje gjithëpërfshirëse për forcimin e kuadrit të politikës makroprudenciale për jobankat. Një kornizë e tillë duhet të miratojë një perspektivë të gjerë të sistemit me fokus në ndërtimin e elasticitetit që më parë (*ex ante*), në vend që të mbështetet në masat pas ndodhisë (*ex post*). Ai duhet të synojë të sigurojë që institucionet jobankare të mund të ofrojnë një burim të qëndrueshëm financimi si në kohë të mira ashtu edhe në të këqija. Dhe duhet të zhvillohet me fleksibilitet për t'iu përgjigjur rreziqeve ndërsa ato evoluojnë, duke pasur parasysh grupin e larmishëm të subjekteve dhe aktivitetëve në sektorin financiar jobankar.

...

Konkluzioni

Roli i sektorit jobankar në financimin e ekonomisë së eurozonës është rritur ndjeshëm me kalimin e kohës. Për sa i përket forcimit të tregjeve evropiane të kapitalit, ky është një zhvillim i mirëpritur. Duke parë përpara, një kuadër makroprudencial më gjithëpërfshirës do ta mbështesë këtë rol edhe më tej: ai do të ndihmojë të sigurojë që institucionet jobankare të jenë më elastike dhe, nga ana tjetër, një burim më i qëndrueshëm financimi për ekonominë reale si në kohë të mira ashtu edhe në të këqija. Ai gjithashtu duhet të zvogëlojë nevojën për ndërhyrje të jashtëzakonshme të bankës qendrore në të ardhmen, duke ndihmuar kështu në zbutjen e shqetësimeve që lidhen me marrjen e tepërt të rrezikut dhe rrezikun moral.

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas njoftimit të Bankës Qendrore të Bullgarisë, për 9 muajt e parë të 2021 aktivet e siguruesve bullgarë u rritën me 9.3% në terma vjetore duke arritur në rreth 9.9 miliardë BGN, ose rreth 5.06 miliardë euro.

Aktivitet e shoqërive të Jo-Jetës u rritën me 6.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 6.86 miliardë BGN në fund të shtatorit, ndërsa aktivet e kompanive të sigurimit të Jetës u rritën me 15.8% duke arritur në 3.03 miliardë BGN. Aktivitet e siguruesve të Jo-Jetës përbënin 69.3% të totalit të tregut të sigurimeve. Në fund të shtatorit 2021, investimet në letrat me vlerë përbënin 43.4% të aktiveve të shoqërive të sigurimit (kundrejt 48% një vit më parë). Aksionet përbënin 18.3% të totalit të aktiveve të siguruesve.

Numri i kompanive të sigurimeve aktive në tregun bullgar u rrit në 51 në fund të shtatorit, nga 50 kompani që ishte një vit më parë.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas Raportit të fundit të Stabilitetit Financiar të Bankës së Greqisë, rreziku i reduktimit të fitimit, kryesisht në terma afatgjatë, mbetet i lartë, për shkak të uljes së kërkesës për sigurime jo të detyrueshme. Sipas këtij raporti, rreziku i normës së interesit është një nga rreziqet kryesore të tregut, pasi siguruesit investojnë në aktive me kthime dukshëm më të ulëta se vitet e mëparshme, ndërkohë që paguajnë përfitime të llogaritura me rritje të kthimeve të garantuara. Sipas raportit, në gjysmën e parë të vitit 2021, aktivet e kompanive të sigurimit vijuan tendencën rritëse të viteve të fundit dhe arritën në 20.2 miliardë euro, krahasuar me 19.79 miliardë euro në fund të vitit të kaluar. Përsa i përket strukturës së aktiveve, investimet te obligacionet e qeverisë mbeten kategoria kryesore e investimeve të kompanive të sigurimit, me 8.78 miliardë euro në qershor 2021 (43.5% e totalit të aktiveve të tyre, kundrejt 9.21 miliardë euro dhe 46.6% e aktiveve të tyre në dhjetor 2020). Sipas Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIORA), rreziku makroekonomik dhe i kreditit si dhe rreziku i tregut mbeten të larta për shkak të pasigurisë së perspektivës financiare. Kombinimi i kësaj pasigurie me efektet e normave të ulëta të interesit ka krijuar sfida të rëndësishme në vitin 2021 për rregullatorët e tregut të sigurimeve në Evropë.

Rreziku i mungesës së aftësisë paguese në tregun grek të sigurimeve mbetet i ulët, pasi të gjitha shoqëritë e sigurimeve kanë një raport aftësie paguese më të lartë se 140% (duke e kaluar kërkesën për kapital me të paktën 40%). Përkundrazi, rreziku i reduktimit të rentabilitetit, veçanërisht në terma afatgjatë, mbetet i lartë, për shkak të uljes së mundshme të kërkesës për sigurime jo të detyrueshme.

Për të adresuar rreziqet e mësipërme, kompanitë e sigurimit të Jetës po ripërcaktojnë gradualisht modelin e tyre të biznesit, duke u fokusuar kryesisht në prodhimin dhe promovimin e sigurimeve me kërkesa të reduktuara për kapital. Kompanitë e sigurimeve të Jo-Jetës po synojnë që, kryesisht nëpërmjet çmimeve të përshtatshme të produkteve të sigurimit në dispozicion të klientëve të rinj, të menaxhojnë në mënyrë dinamike paqëndrueshmërinë rënëse të ciklit të sigurimit të vërejtur, veçanërisht në sektorin e përgjegjësive për automjetet, për shkak të trafikut të reduktuar gjatë pandemisë.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave më të fundit të publikuara nga Banka Kombëtare e Hungarisë (National Bank of Hungary, MNB) siguruesit hungarezë realizuan në tremujorin e tretë 2021 një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 1001.2 miliardë HUF, ose rreth 2.8 miliardë euro. Kjo shënonte një rritje prej 11.6% e shprehur në terma vjetore. E ndarë sipas sektorëve, vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me 16.9% në sigurimet e Jetës, duke arritur në 445 miliardë HUF ose 1.2 miliardë euro dhe një rritje prej 7.6% të primeve të sigurimit të Jo-Jetës (duke arritur në 556.3 miliardë HUF ose 1.5 miliardë euro.

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, portofoli total i kontratave të shoqërive të sigurimit u rrit me 1.2% nga niveli i një viti më parë, duke shënuar një rritje me mbi 175,300 kontrata të reja. Kjo rritje lidhet më shumë me rritjen prej 1.73% e numrit të kontratave të sigurimit të Jo-Jetës (në 12,277,158), shoqëruar me një rënie të numrit të kontratave të sigurimit të Jetës (një rënie prej 1.43% (në 2,309,823). Si rezultat, numri i përgjithshëm i kontratave të sigurimit arriti në 14.6 milionë në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021.

Përsa i përket dëmeve, totali i dëmeve të shkaktuara u rrit me 13.23% në terma vjetorë duke arritur në 538.7 miliardë HUF ose 1.5 miliardë euro.

Të tjerë tregues statistikorë, sipas informacionit nga Shoqata Hungareze e Siguruesve, (*Hungarian Insurers Association MABISZ*), paraqesin se siguruesit hungarezë raportuan dëme të papaguara (pagesat dhe rezervat, të marra së bashku) në segmentin e sigurimeve bujqësore me vlerë 10 miliardë HUF ose 28 milionë euro. Në njoftimin për media nga përfaqësuesit e MABISZ theksohet se "... deri në fund të tetorit 2021, janë hapur më shumë se shtatë mijë dosje dëmshpërblimi lidhur me sigurimin e kulturave bujqësore nga siguruesit, në vlerë prej rreth 10 miliardë HUF".

Nga ky total, shumica e kërkesave, rreth 8 miliardë HUF kanë të bëjnë me dosjet e dëmeve që vijnë nga breshëri, rreth 800 milionë HUF nga thatësira dhe 400 milionë HUF nga dëmet nga ngricat pranverore.

Ndër kulturat e siguruara, nga moti i keq kanë pësuar më së shumti misri, luledielli, drithërat, frutat dhe perimet.

QIPRO

www.xprimm.com

Siguruesit qipriotë arritën 476.5 milionë euro prime të shkruara bruto në 6-mujorin e pare 2021, duke u rritur me 19.2 milionë euro (ose me 4.2% në vit), sipas raportit të publikuar nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros - IAC.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 257.7 milionë euro, me një rënie me 0.5%, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës gjeneroi prime prej 218.8 milionë euro, ose 10.4% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Gjatë gjashtëmujorit të parë, vlera e dëmeve bruto të ndodhura ishte rreth 212 milionë euro (në rënie me 6.7%), nga të cilat 102 milionë euro lidhen me sigurimin e Jetës, 55.5 milionë euro me sigurimin motorik dhe 33 milionë euro në klasat e aksidenteve dhe shëndetit.

RUMANI

www.xprimm.com

Sipas një deklarate të Zëvendës-presidentit për Sigurimet dhe Risigurimet të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë, gjatë 9-mujorit 2021, tregu rumun i sigurimeve u rrit me 15%, e shprehur në terma vjetore. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për 9-mujorin 2021 arriti në 9.8 miliardë RON ose rreth 1.97 miliardë euro, ku sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 13%, ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me 22%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Duke vlerësuar rritjen e sigurimeve të Jetës, Zëvendës-presidenti për Sigurimet dhe Risigurimet i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë theksoi se "...Sigurimet e Jetës janë ende larg potencialit të këtij tregu, larg nevojës për të mbuluar këtë treg, ato përfshijnë në masë të madhe sigurimin shëndetësor, i cili është gjithashtu sigurimi me potencial të madh në Rumaní."

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimet e Jo-Jetës arriti në rreth 1.57 miliardë euro. Sigurimet e Jo-Jetës ende dominohen nga sigurimi MTPL, me vlerë të primeve të shkruara bruto 3.66 miliardë RON, duke shënuar një rritje prej 18% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi KASKO shënoi një rritje prej 14% në 9 muajt e parë të 2021, duke tejkaluar 2 miliardë RON. Po kështu sigurimet nga zjarri u rritën me 8%, duke arritur në rreth 1 miliardë RON. Rritje të lehtë patën edhe klasat e tjera të sigurimit të Jo-Jetës.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimet e Jetës, gjatë 9-mujorit 2021, arriti në 406.4 milionë euro. Në sigurimet e Jetës, rritje të primeve të shkruara bruto patën "Sigurimet e Jetës, Anuitetet dhe sigurimet suplementare të Jetës" me 25% rritje dhe "Sigurimet e Jetës dhe Anuitetet të lidhura me fondet e investimeve" me 21% rritje.

SERBI

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të publikuara në faqen zyrtare online të Bankës Kombëtare të Serbisë (NBS), tregu serb i sigurimeve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021 u zgjerua me 9.7%, e shprehur në terma vjetore duke arritur në 88.5 RSD (ose 754 milionë euro).

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rrit me 10.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 69.2 miliardë dollarë, ndërsa tregu i sigurimit të Jetës realizoi rreth 19.3 miliardë RSD prime, duke shënuar rritje prej 6.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Vlera e dëmeve të paguara arriti në 37.3 RSD me rritje prej 2.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, nga të cilat 12.1 miliardë RSD ishin dëmshpërblime të lidhura me sigurimin e Jetës (rritje me 28.6%) dhe 25.2 miliardë RSD ishin dëme të paguar për sigurimet e Jo-Jetës (duke shënuar një rënie me 7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë).



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al